



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Maj 2021.
2. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, për furnizimin e energjisë elektrike.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Info-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
5. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 478, seria T20, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, i ndryshuar.
6. Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017”.
7. Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar.